



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 846 Prot.

Tiranë, më 06.07 2018

VENDIM Nr. 124, datë 27.06.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 6, datë 27.06.2018, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit "Ndërtimi i Parkut Eolik", Tepelenë-subjekti "Alb-Building" sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Znj. Lida Miraj.

VENDOSI:

1. Të realizohen nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dy sondazhe me dimensione 2m x 2m, në koordinim me individin e licencuar në arkeologji Znj. Lida Miraj, e cila ka paraqitur Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor për projektin "Ndërtimi i Parkut Eolik", Tepelenë. Raporti i sondazheve të paraqitet në KKA e radhës.
2. Subjekti "Alb-Building" sh.p.k. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje dy palëshe me Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të realizojë sondazhet e sipërpërmendur.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për sondazhet e realizuara nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes dy palëshe.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO FURXHI  
MINISTRE



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO

